



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**  
**Agjencia e Prokurimit Publik**



*100 Vjet Pavarësi*

---

*Adresa : Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Keshilli i Ministrave Tel. 04 2277510*

---

**Nr. 11469 Prot.**

**Tiranë, më 07.11. 2012**

**Lënda:** Njoftim për të gjithë Operatorët Ekonomikë.

Në kuadër të përmirësimeve dhe rritjes së mëtejshme të sigurisë së sistemit të prokurimit elektronik, Agjencia e Prokurimit Publik bëri të mundur finalizimin e projektit për Enkriptimin e dokumenteve të skedarit "Dokumente Financiare". Nisur nga përmirësimet që janë bërë në sistemin e prokurimit elektronik për rritjen e sigurisë së ofertave, ju bëjmë me dije se:

Të gjitha dokumentat që do të bashkëlidhen tek skedari "Dokumente Financiare" pasi të jetë klikuar butoni përditësim, do të Enkriptohen duke mundësuar një ruajtje të informacionit të hedhur në sistem deri në hapjen e ofertave. Emërtimi i dokumentave të bashkëlidhur në këtë skedar do të marrë si prapashtesë një numër nga sistemi.

Për shkak të enkriptimit edhe në rastet kur vete operatori ekonomik që ngarkon këto dokumenta tek skedari "Dokumente Financiare", tenton të hapë një dokument të bashkëlidhur, para datës së zhvillimit të tenderit nuk do të hapet. Përmbatja e këtyre dokumentave do të mund të shihet vetëm pasi të jenë hapur ofertat nga Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor.

Në cdo rast operatorët ekonomikë mund të heqin dokumentat që ngarkohen tek skedari "Dokumente Financiare" dhe të ngarkojnë dokumenta të tjerë deri në orën dhe datën e hapjes së ofertave, të përcaktuar në sistem nga autoriteti kontraktor.

**Create Tender**

**Ju lutem ngarkoni dokumentat ne format .pdf**

**Info**

**Call for tenders** Test call for tenders - Small Value 001 **Offer Number** OFFER-0522/22102012

**Proof Documents**

| Attachment File                                         | Created |                                                                                                                                                                         |
|---------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AL_Notification.pdf (1652/) <a href="#">Attach File</a> |         |   |
| <a href="#">Append new row</a>                          |         |                                                                                                                                                                         |

**Financial Documents**

| Attachment File                                                                         | Created |                                                                                                                                                                         |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DataItem1_7692b3b6-7884-41c2-83db-187eb79ea037.pdf (250745) <a href="#">Attach File</a> |         |   |
| <a href="#">Append new row</a>                                                          |         |                                                                                                                                                                         |

**Technical Documents**

| Attachment File                | Created |                                                                                                                                                                         |
|--------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <a href="#">Attach File</a>    |         |   |
| <a href="#">Append new row</a> |         |                                                                                                                                                                         |

**Union**

Roundtrip: -> ReadInvitationMessage18 -> Form1 -> Form2.1

Gjithashtu në fund të faqes së APP-së do iu shfaqet një mesazh, në të cilin ju rekomandohet ndryshimi i fjalëkalimin tuaj nqs ai nuk është ndryshuar në një afat kohor prej 90ditësh.

**Ju rekomandojmë ndryshimin e fjalekalimit per arsye sigurie. (Intervali 90 ditor ka skaduar)**

Adresa : Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Keshilli i Ministrave, Tel.+355 4 2277510, Email:infoapp@app.gov.al

Ju sugjerojmë për arsye sigurie, fjalëkalimi Juaj të ketë të paktën 7 shkronja dhe të përbëhet nga :

1. Shkronja kapitale nga A-Z
2. Shkronja të vogla nga a-z
3. Numra nga 0 në 9
4. Simbole të veçanta ose karaktere jo alfabetike (!, @, #, \$...etj)

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**D R E J T O R**  
**Klodiana CANKJA**